

# Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit



*Hazret* Mirza Bashir-ud-Din  
Mahmud Ahmed<sup>ra</sup>



# Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit

*Hazret* Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed<sup>ra</sup>  
Kalif i Dytë i Xhematit Musliman Ahmedia

Tiranë, 2019

## **Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit**

Autor: *Hazret* Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed<sup>ra</sup>,

Kalif i Dytë i Xhematit Musliman Ahmedia (1914 – 1965)

(Albanian rendering of “*Ten Proofs for The Existence of God*”)

Botimi i parë në gjuhën urdu: mars 1913

Botimi i parë në shqip: 2019

E përktheu nga origjinali: Samad Ahmed Ghori

Redaktore gjuhësore: Ina Komino

### **Botues:**

Fond. Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë

Tiranë, Shqipëri (Albania)

© Islam International Publications Ltd.

*Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.*

Kopertina: Fazle Umar Foundation

U shtyp në shtypshkronjën: Gent.grafik, Tiranë

ISBN: 978-9928-4491-2-2

## PARATHËNIE

Ka një debat të ashpër dhe të nderur mes ateistëve dhe teistëve për ekzistencën e Zotit, gjë që është shenjë e mirë e një fryme intelektuale të shëndetshme e të gjallëruar. Diskutimi mbi ekzistencën e Zotit duhet të fillojë me pranimin se barra e provës qëndron te teistët, domethënë te ata që besojnë në Zot.

Botuar fillimisht në mars të vitit 1913 në revistën “*Tash’heezul-Azhaan*”, libri në gjuhën urdu “*Das Dalaail Hasti Bari Ta’alaa*” (Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit) është i domosdoshëm për këdo që dëshiron të kuptojë aspektin më themelor të besimit. Në këtë libër *Hazret Mirza Bashir-ud-Din Mahmud Ahmed*<sup>ra</sup>, Kalif i Dytë i Mesihut të Premtuar, trajton një argument kryesor të ateistëve se nëse Zoti ekziston pse nuk mund ta shohim Atë. Më pas, autori parashtron dhjetë argumente nga Kurani Famëlartë për të treguar me forcë bindëse se ekzistenca e Zotit mund

të vërtetohet me siguri të plotë dhe në një mënyrë që nuk mund të hidhet poshtë.

Kemi kënaqësinë të botojmë përkthimin në gjuhën shqipe të këtij libri. I jemi mirënjohës z. Samad Ahmed Ghorit, që u ngarkua për përkthimin e tij, dhe znj. Ina Komino për rishikimin dhe verifikimin e dorëshkrimit. Zoti i shpërbleftë!

Munir-ud-Din Shams

*Add. Vakilut-Tasnif*

(Drejtor i botimeve të Xhematit Musliman Ahmedia)

30 shtator 2019

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ      نَحْمَدُهُ وَنُصَلِّي عَلَى رَسُولِهِ الْكَرِيمِ

*Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit  
Atë e lavdërojmë dhe i dërgojmë salavate të Dërguarit të Tij fisnik*

أَفِي اللَّهِ شَكٌّ فَاطِرِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ

*“A dyshoni në Allahun, Krijuesin e qiejve dhe të tokës?!”*

## *Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit të Madhërishëm*

Kundërshtimi më i madh ndaj feve dhe besimeve, i ngritur nga bota që beson vetëm në aspektin lëndor të gjërave, është mbi vetë ekzistencën e Zotit. Idhujtarët pavarësisht se adhurojnë idhuj të tjerë krahas Zotit, prapëseprapë të paktën besojnë në ekzistencën e Tij. Kurse ateistët e mohojnë tërësisht. Shkenca e sotme dijen e çdo gjëje e ka bazuar mbi shqisën e të parit, për këtë arsye, ateistët në përgjithësi pyesin:

Nëse Zoti ekziston, na e trego që ta shohim! Si mund ta besojmë Atë pa e parë vetë?

Fryma e botës së sotme ka fshirë nga zemrat e shumë të rinjve shenjat e Asaj Qenieje të Pastër. Studentë të shkollave të larta, pedagogë, avokatë etj., gjithnjë e më tepër po bëhen mohues të Zotit. Rreth jush mund të hasni me mijëra njerëz, të cilët për shkak të frikës nga populli a vendi, nuk e shfaqin mendimin e tyre, por e vërteta është se përbrenda nuk besojnë hiç në ekzistencën e Zotit. Prandaj, e pashë të udhës, nëse Zoti i Madhërishëm më mundëson, të shkruaja e të botoja një libërth për këtë temë, se ndoshta ndonjë shpirt i pastër përfiton.

“DO TË BESOJMË NË ZOT,  
VETËM KUR TA SHOHIM ME SY!”

Më ka rastisur shpesh ta dëgjoja këtë kërkesë, dhe çdo herë më ka habitur. Gjëra të ndryshme njeriu i njeh nëpërmjet shqisave të ndryshme. Disa gjëra i njeh me të parë, disa i njeh me të prekur, disa me të nuhatur, disa me të dëgjuar, disa me të shijuar e me radhë. Ngjyrën e bojës mund ta dalloni vetëm duke e parë dhe jo duke e nuhatur, as duke e prekur, e as duke e shijuar. A nuk do t'ju duket qesharak ai që këmbëngul se do ta dallojë ngjyrën, duke i dëgjuar zërin?!

Tingujt i njohim nëpërmjet dëgjimit. A nuk do ta quanim qesharak atë që do të pretendonte se sheh me sy zërin e dikujt?! Gjithashtu, aromën e ndieni me shqisën e të nuhaturit. Por nëse dikush ju kërkon: “do ta besoj se ky është trëndafil, nëse më mundëson ta ha aromën e tij”, a do ta merrnit seriozisht?! Po ashtu, gjërat që dallojmë nëpërmjet të shijuarit, siç janë ëmbëlsirat, të kripurat, të hidhurat, të thartat etj., nëse dikush këmbëngul t’i njohë nëpërmjet të nuhaturit, nuk do të arrijë kurrë. Pra, nuk është domosdoshmëri që ne të besojmë vetëm gjërat që na dalin para syve, e ato që nuk i shohim, të mos i besojmë, sepse kështu do të na duhet të mohojmë aromën e trëndafilin, thartësinë e limonit, ëmbëlsinë e mjaltit, hidhësinë e pelinit, fortësinë e hekurit, jehonën e zërit dhe çdo gjë tjetër si këto, pasi nuk i shohim dot me sy. Prandaj, a nuk ju duket i pakuptimtë kundërshtimi i atyre që nuk besojnë në Zot vetëm e vetëm sepse nuk e shohin me sy Atë? Duke qenë se kundërshtarët e tillë besojnë në ekzistencën e gjërave që kemi renditur më sipër edhe pa i parë ato me sy, përse vallë vetëm për Qenien e Zotit të Madhërishëm thonë se nuk e besojnë përderisa nuk e shohin me sy Atë?!



Përveç kësaj, vetëm brenda trupit të njeriut ka shumë gjëra që të gjithë ne besojmë se ekzistojnë dhe që funksionojnë, pa i parë ndonjëherë me sy. A besoni apo jo se në trupin tuaj keni një zemër, një mëlçi, mushkëri, brinjë, shpretkë, edhe pse kurrë nuk i keni parë ato me sy? Nëse njeriut do t'i duhet t'ia vinim përpara gjithë këto, a do të mbetet i gjallë për t'i parë ato me sytë e vet?!

Në shembujt që janë ilustruar më sipër ju tregova për gjërat që pavarësisht se nuk ka nevojë t'i shohim me sy për t'i vërtetuar, na duhet patjetër njëra nga shqisat e mbetura. Por ka edhe shumë gjëra të tjera që nuk i dallojmë dot drejtpërdrejt me asnjërin prej këtyre pesë shqisave dhe metoda për t'i njohur ato është krejtësisht tjetër. Për shembull, mendja, kujtesa, intelekti, etj. janë gjërat që askush në botë nuk i mohon dot, por a mundet vallë që dikush ta ketë parë mendjen, ose ta ketë dëgjuar, ose ta ketë shijuar ose ta ketë nuhatur?! Pse atëherë beson se mendja ekziston?!

Mendoni pak për forcën. Çdo njeri ka forcë, dikush më pak, dikush më shumë, por këtë a e ka parë ndokush me sy në formë fizike, ose a e ka dëgjuar, a e ka prekur apo e ka shijuar?! Pse atëherë çdo njeri në botë, qoftë i shkolluar apo i pashkolluar, beson se forca ekziston.

Arsyeja është që shohim pasojat dhe ndikimet e forcës. Po ashtu, kur njeriu has një vështirësi, mendon për të gjetur një rrugëdalje dhe e gjen atë. Atëherë kupton se ka diçka që i shërben në situata të tilla dhe e quan mendje. Pra, mendjen ne nuk e kemi zbuluar drejtpërdrejtë nga asnjëra prej pesë shqisave tona, por vetëm duke dëshmuar mrekullitë e saj.

Po kështu, vërejmë që njeriu ngre barra shumë të rënda, dhe kuptojmë se ai zotëron diçka që e mundëson t'i ngrejë ato ose arrin t'i nënshtrojë gjërat më të dobëta se ai, dhe këtë e quajmë forcë.

Kështu që, një gjë e caktuar sa më shumë të jetë e patrupëzuar, aq më shumë ajo është larg shikimit të njeriut dhe njeriu gjithmonë do ta vërtetojë atë nëpërmjet ndikimeve të saj dhe jo nëpërmjet shqisës së të parit, as të të shijuarit, as të të nuhaturit dhe as të të prekurit.

Kurse Allahu i Madhërishëm është Qenia më e patrupëzuar se çdo gjë tjetër e patrupëzuar. Si mundet vallë që njerëzit t'i lejojnë vetes t'i vënë kufizime të tilla pikërisht Zotit duke thënë se nuk do ta besojnë, derisa nuk do ta shohin Atë?! Vallë, kanë parë me sy rrymën elektrike? Nëse jo, a e mohojnë ekzistencën e energjisë së saj, dhe të të gjitha funksioneve që realizohen përmes

saj?! Zbulimi i etherit (mediumit) në botën fizike shkaktoi një jehonë, por shkencëtarët deri më sot nuk kanë mundur dot të krijojnë ndonjë mjet për ta parë atë, apo për ta dëgjuar, për ta shijuar apo për ta prekur atë. Por nëse mohojnë ekzistencën e tij, nuk mund ta shpjegojnë dukurinë sesi mbërrin drita e diellit në Tokë. Pra, a nuk është padrejtësi që duke i pasur këto dëshmi, për çështjen e Zotit njeriu të këmbëngulë se do ta besojë vetëm nëse do ta shikojë Atë?!

Realisht, Allahu i Madhërishëm shikohet, por me ata sy që janë të aftë ta shohin Atë. Nëse dikush e kërkon Zotin, Zoti i shfaqet atij përmes fuqive dhe mrekullive të Tij dhe pavarësisht se Ai është i fshehtë, mund të bëhet gjëja më e dalluar për të. Kurani Famëlartë e shpjegoi këtë temë shkurt, por në mënyrë mbresëlënëse. Zoti i Madhërishëm thotë në Kuran:

لَا تُدْرِكُهُ الْأَبْصَارُ وَهُوَ يُدْرِكُ الْأَبْصَارَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ

Sytë nuk e arrijnë Atë dhe Ai i arrin sytë. Ai është i Mprehti, i Gjithinformuari.<sup>1</sup>

Në këtë ajet Zoti i Madhërishëm i tërheq vëmendje njeriut duke thënë se shikimi i tij nuk ka aftësi ta shohë

---

<sup>1</sup> Kurani Famëlartë 6:104.

Qenien e Zotit, sepse Ai është i Patrupëzuar. Gjërat që nuk kanë trup, nuk rroken nga sytë, siç është mendja, forca, shpirti, rryma elektrike, etheri, etj.. Ndërsa Zoti i Madhërishëm është Qenia më e patrupëzuar se gjithçka tjetër, si mund ta rrokin sytë e njerëzve Atë?!

Shtrohet pyetja: Si mundet atëherë që njerëzit ta shohin dhe ta njohin Atë? Përgjigjen e jep pjesa e dytë e këtij ajeti që thotë: “Ai i arrin sytë”. Pavarësisht se shikimi i njeriut është i dobët dhe si i tillë nuk e rrok dot Zotin, Ai manifeston Vetën e Tij përpara njeriut, duke i treguar fuqinë madhështore, krijimtarinë e jashtëzakonshme dhe cilësitë e Tij të përsosura. Ai shfaqet përpara njeriut herë përmes shenjave të llahtarshme, herë përmes profetëve të Tij, herë përmes shenjave të mëshirës së Tij, e herë duke i pranuar lutjet dhe përgjërimet.

Pra, nëse e kushtëzoni besimin në Zot me mundësinë për ta parë me sy Atë, atëherë do t’ju duhet të mohoni pesë të katërtat e fenomeneve, e madje sipas disa filozofëve që pohojnë se asgjë nuk është e dukshme në botë, përveç cilësive të gjërave, do t’ju duhet të mohoni të gjitha fenomenet.

Pas këtij sqarimi, më lejoni të paraqes prova që tregojnë ekzistencën e Zotit dhe që bindin njeriun se ai nuk është i vetëkrijuar, por e ka një Krijues.

## ARGUMENTI I PARË

Sipas bindjes sime Kurani Famëlartë i ka treguar të gjitha mjetet për të arritur përsosurinë shpirtërore, prandaj, të gjitha argumentet për ekzistencën e Zotit do t'i paraqes po nga Kurani Famëlartë.

وَمِنَ اللَّهِ التَّوْفِيقُ-

*Prej Allahut vjen mundësia!*

Duke qenë se me të ardhur në këtë botë, njohuritë e para njeriu i merr përmes aftësisë së tij të të dëgjuarit, ndaj argumenti i parë i ekzistencës së Zotit që doja të paraqisja, lidhet pikërisht me kujtesën e tij dëgjimore.

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى ۖ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى ۝ بَلْ تُؤْثِرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ۖ وَالْآخِرَةَ خَيْرٌ وَأَبْقَى ۖ إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى ۖ صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى ۖ

*Fitoi ai që u pastrua. Dhe përmendi emrin e Zotit të tij, dhe e adhuroi. (Pra, së pari ta pranojë edhe gojarisht Zotin e tij e më pas ta adhurojë Atë edhe praktikisht.) Por ju e zgjidhni jetën e kësaj bote, ndërkohë ahireti (ose jeta përfundimtare) është më e miri dhe më e qëndrueshmi. Këtë e thonë (jo vetëm Kurani Famëlartë, por) edhe Librat*

*e parë, pra, edhe Libri i Ibrahimit, edhe Libri i Musait.*<sup>2</sup>

Në këtë ajet, Zoti i Madhërishëm u jep argument kundërshtarëve duke thënë se ata që heqin dorë nga tundimet vetjake, që besojnë në Zotin e Madhërishëm e më pas tregojnë bindje të plotë ndaj Tij, gjithnjë fitojnë dhe korrrin sukses dhe se prova e këtij mësimi është përbashkësia e tij edhe në fetë e mëparshme. Kështu që, Kurani sjell si shembuj fetë kryesore të kohës, judaizmin dhe krishterimin, dhe ngaqë u drejtohet idhujtarëve të Mekës, u kujton Hazret Ibrahim<sup>as</sup> dhe Hazret Musain<sup>as</sup>, të cilët ata i pranonin dhe u thotë: Edhe këta të njëjtin mësim kanë dhënë.

Kështu që, një prej dëshmimeve të fuqishme që Kurani Famëlartë jep për ekzistencën e Zotit është që të gjitha fetë janë unanime dhe të gjithë popujt janë në një mendje për këtë. Sa më shumë të thelloheni në këtë argument, aq më i pastër dhe aq më i vërtetë ju duket. Është fakt i njohur që të gjitha fetë e botës bashkohen te kjo pikë: ka një Zot që krijoi gjithë këtë univers. Ndonëse mund të ketë dallime në doktrina dhe besime për shkak të dallimeve gjeografike dhe

---

<sup>2</sup> Kurani Famëlartë 87:15-20.

rrethanore, të gjitha fetë e pranojnë universalisht ekzistencën e të Madhit Zot. Të gjitha fetë ekzistuese, pra Islami, Krishterimi, Judaizmi, Budizmi, Sikhizmi, Hinduizmi dhe Zoroastrizmi, që të gjitha besojnë në ekzistencën e një Zoti të Plotfuqishëm, që e quajnë *Allah*, *Elohim*, *Pàrààmēshvàr*, *Pàrààmātma*, *Sàtgurū* ose *Jezdān*, pavarësisht se kanë pikëpamje të ndryshme për sa u përket attributeve të Tij.

Edhe për fetë që janë zhdukur, të dhënat arkeologjike tregojnë se ato që të gjitha besonin në një Zot. Pra, si ata që jetonin të izoluar në kontinentin amerikan, si ata që jetonin nëpër pyje të Afrikës, si banorët e lashtë të Romës, të Anglisë, të Java-Sumatrasë, të Japonisë, të Kinës, të Siberisë apo të Mançurisë, të gjithë e kanë pasur besimin në një Zot. Si mund të ketë arritur kjo harmoni në besim dhe kush ishte ai që ua tregoi banorëve të Amerikës besimin dhe bindjet e banorëve të Indisë ose banorëve të Kinës besimin e afrikanëve të lashtë?! Në të kaluarën nuk kishin as mjetet e transportit dhe të telekomunikacionit, si treni, telegrami, posta etj., siç i kemi sot, as nuk kishin avionë ose anije të mëdha që venin e vinin ndërmjet kontinenteve. Ata udhëtonin vetëm me kuaj e mushka dhe, edhe anijet me vela që kishin, u duheshin muaj për të bërë një

udhëtim që në kohën tonë e realizojmë vetëm për disa ditë. Shumica e vendeve as nuk ishin zbuluar për të gjithë njerëzit. Atëherë si mund të kenë bërë pakt pikërisht për këtë besim popuj të largët, me kultura, zakone dhe gjuhë kaq të ndryshme? Është vështirë të bashkohen dy njerëz në diçka që është e sajuar. Prandaj, fakti që kaq shumë popuj dhe vende kanë pasur besimin në një Zot, pa pasur mundësi për shkëmbimin e ideve, është dëshmi e vërtetësisë së këtij besimi dhe është dëshmi që atyre u ishte kumtuar ky besim përmes një metode të panjohur, të cilën e ka sqaruar Islami (në Kuranin Famëlartë). Historianët pajtohen se kur një informacion është pohuar nga kronistët e popujve të ndryshëm [antikë], ai duhet të konsiderohet autentik. Prandaj, kur miliona njerëz bashkohen për këtë besim themelor, pse nuk duhet pranuar që ata ta kenë pranuar për shkak të një manifestimi Hyjnor?!



## ARGUMENTI I DYTË

Argumentin e dytë për ekzistencën e Zotit e gjejmë në këto ajete të Kuranit Famëlartë:

وَتِلْكَ حُجَّتُنَا آتَيْنَاهَا إِبْرَاهِيمَ عَلَىٰ قَوْمِهِ نَرْفَعُ دَرَجَاتٍ مِّنْ نَّشَأِهِ إِنَّ رَبَّكَ حَكِيمٌ عَلِيمٌ ﴿٦٧﴾ وَوَهَبْنَا لَهُ إِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ كُلًّا هَدَيْنَا وَنُوحًا هَدَيْنَا مِن قَبْلُ وَمِن دُرِّيَّتِهِ دَاوُدَ وَسُلَيْمَانَ وَأَيُّوبَ وَيُوسُفَ وَمُوسَىٰ وَهَارُونَ وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ ﴿٦٨﴾ وَزَكَرِيَّا وَيَحْيَىٰ وَعِيسَىٰ وَإِلْيَاسَ كُلٌّ مِّنَ الصَّالِحِينَ ﴿٦٩﴾ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيُوسُفَ وَلُوطًا وَكُلًّا فَضَّلْنَا عَلَى الْعَالَمِينَ ﴿٧٠﴾

Ky ishte argumenti Ynë që ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne ngremë në pozitë kë të duam. Sigurisht, Zoti yt është i Urtë, i Gjithëdijshtëm. I dhuruar Is'hakun dhe Jakubin. Të gjithë i udhëzuar. Më parë Nuhun e udhëzuar dhe edhe nga pasardhësit e tij: Daudin, Sulejmanin, Ejubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë mirëbërësit. Po ashtu, (edhe) Zekerjjanë, Jahjanë, Isain dhe Iljasin. Të gjithë këta kanë qenë ndër të dëlirët. Dhe Ismailin, Eljesanë, Junusin dhe Lutin. Të gjithë këtyre u kemi dhënë epërsi mbi botët.<sup>3</sup>

<sup>3</sup> Kurani Famëlartë 6:84-87.

Dhe pas disa ajetesh thotë:

أُولَئِكَ الَّذِينَ هَدَى اللَّهُ<sup>ص</sup> فَبِهِدَاهِهِمْ آقَّتَدَةٌ

Këta janë ata, që i udhëzoi Allahu. Ndaj, ndiqe udhëzimin e tyre (që Allahu ua kishte dhënë).<sup>4</sup>

Këto ajete ngrenë pyetjen se dëshminë e kujt duhet pranuar: të kaq shumë njerëzve të pastër e të sinqertë, apo të atyre që nuk dinë dhe që as nuk mund të maten me të parët në sjellje e në morale? Natyrisht, duhet të pranojmë dëshminë e atyre njerëzve të cilët kanë provuar përmes sjelljes dhe veprave të tyre pastërtinë, sinqeritetin, dëlirësinë dhe qëndrimin e tyre larg mëkatit dhe gënjeshtërisë. Madje, çdo njeri ka për detyrë t'i ndjekë pikërisht këta dhe të distancohet nga çdokush që u del kundër.

Vërejmë se të gjithë ata që kanë përhapur dhe promovuar mirësinë dhe moralin, të cilët me veprat e tyre kanë provuar pastërtinë e tyre përpara botës, dëshmojnë unanimisht se ka një Qenie Supreme që thirret me emra të ndryshëm në gjuhë të ndryshme: *Allah, Zot, Pàrà-mëshvâr* etj..

---

<sup>4</sup> Kurani Famëlartë 6:91.

Dy njerëz të dëlirë të Indisë, Ramaçandra<sup>as</sup> dhe Krishna<sup>as</sup>, i dëliri i Persisë Zarathustra<sup>as</sup>, i dëliri i Egjiptit Musai<sup>as</sup>, i dëliri i Nazaretit Jezusi<sup>as</sup>, i dëliri i Panxhabit Baba Nanak dhe më pas më i dëliri nga gjithë të dëlirët, drita e Arabisë, Muhammedi<sup>savs</sup>; të cilin që nga vegjësia populli i tij e quante *të vërtetë* e *të ndershëm* dhe që u thotë:

﴿ فَقَدْ لَبِثْتُ فِيكُمْ عُمُرًا مِّن قَبْلِهِ ؕ أَفَلَا تَعْقِلُونَ ﴾

Sigurisht, jetova një jetë të gjatë mes jush edhe përpara këtij (mesazhi), pra, a nuk kuptoni?!<sup>5</sup>,

dhe populli i tij nuk mund të guxonte ta akuzonte për ndonjë gënjeshtëri; dhe mijëra njerëz të tjerë të dëlirë që u shfaqën herë pas here në botë dhe njëzëri njoftuan: “Zoti ekziston”, dhe jo vetëm kaq, por thanë: “*Ne e takuam Atë dhe komunikuan me Të.*”

Edhe filozofët më të mëdhenj që kanë lënë gjurmë të qarta në botë, nuk kanë mundur të paraqesin një arritje që përputhet deri në një pjesë të njëmijtë të arritjeve të këtyre njerëzve të dëlirë. Në fakt, nëse do të krahasoheshin, filozofët do të dalloheshin vetëm me fjalë, dhe shumë pak me vepra. Vërtetësinë dhe

---

<sup>5</sup> Kurani Famëlartë 10:7.

drejtësinë që treguan profetët dhe njerëzit e dëlirë, a kanë arritur t'i shfaqin filozofët?! Këta të fundit u japin njerëzve mësimin e drejtësisë por shpesh nuk ruhen nga gënjeshtria. Kurse njerëzit e dëlirë të Zotit u përballën me mijëra vështirësi vetëm për të ruajtur drejtësinë. Kundërshtarët ngritën plane për t'i vrarë, por ata nuk u lëkundën. U përqeshën dhe u poshtëruan nëpër rrugica e nëpër sheshe, u dëbuan nga vatrat e tyre, i gjithë populli i bojkotoi dhe i braktisi, por ata nuk e lëshuan idealin dhe besimin e tyre. Nuk ka asnjë rast që ata të kenë gënjyer, qoftë edhe për të shpëtuar veten. Veprat e tyre, urrejtja e tyre për botën materiale dhe largimi i tyre nga dukja kanë provuar se ata nuk kishin asnjë interes vetjak dhe ishin tërësisht vetëmohues. Pikërisht njerëzit e tillë kaq të vërtetë e kaq të besueshëm njëzëri pohojnë: *“Ne e takuam Zotin e Madhërishtëm, dëgjuam Fjalën e Tij dhe dëshmuam Manifestimin e Tij”*, atëherë, kush mund t'i kundërshtojë ata, vallë?! Shohim rëndom njerëz që gënjejnë. Edhe njerëzve të tillë, nëse bashkohen dhe dëshmojnë njëzëri për diçka, detyroheni t'u besojmë. Njerëz që nuk u njohim as emra dhe as karaktere, kur botojnë studimet e tyre nëpër gazeta, u besojmë. Vallë, vetëm njerëzve të drejtë që përmenda më sipër nuk na u lejuaka t'u besojmë?! Njerëzit thonë se Londra është një qytet dhe ne e besojmë këtë si fakt. Gjeografët

shkruajnë se Amerika është një kontinent dhe ne e pranojmë. Udhëtarët pohojnë se Siberia është një tokë e madhe e pabanuar dhe ne nuk e kundërshtojmë. Pse? Sepse shumë njerëz kanë dhënë dëshmi për këto fakte, por ne nuk ua njohim karakterin këtyre dëshmitarëve nëse janë të sinqertë apo gënjeshtarë në jetën e tyre. Por ata që japin dëshminë okulare për ekzistencën e Zotit të Madhërishëm janë të tillë që sinqeriteti dhe vërtetësia e tyre është e qartë si drita e diellit, që sakrifikuan pasurinë, shtëpinë, jetën dhe nderin për vendosjen e drejtësisë në botë. Atëherë si mund të jetë e drejtë që ne t'i besojmë gjithkujt, dhe pikërisht këtyre të sinqertëve jo?! Nëse ekzistenca e Londrës mund të na vërtetohet vetëm duke dëgjuar dëshminë e disa njerëzve, pse nuk mund të na provohet edhe ekzistenca e Allahut të Madhërishëm nga dëshmia e mijëra njerëzve të drejtë e të sinqertë?!

Kështu që, mijëra njerëz të sinqertë kur japin dëshminë e tyre personale për ekzistencën e Zotit, dëshmia e tyre në asnjë mënyrë nuk mund të refuzohet. Është e çuditshme që të gjithë ata që kanë pasur këtë përjetim, unanimisht deklarojnë se Zoti ekziston, kurse ata që nuk kanë lidhje me sferën e spiritualitetit pohojnë: Mos u besoni këtyre kur thonë se ka Zot! Por në të vërtetë,

sipas kritereve të dëshmimit, edhe sikur dy njerëz që janë të barabartë në sinqeritetin e tyre, dëshmojnë në një çështje të caktuar, ndër të cilët njëri pohon se ka parë diçka të caktuar, kurse tjetri pohon se nuk e ka parë, i jepet përparësi dëshmisë së atij që ka parë dhe jo tjetrit, pasi ekziston mundësia që ky i dyti të mos e ketë vënë re, por nuk ka shans që ai që ka parë, të mos e besojë atë. Kështu që, dëshmia e atyre që kanë parë Zotin pa dyshim përbën një argument të fortë kundër atyre që e mohojnë Atë.

### ARGUMENTI I TRETË

Argumenti i tretë që do të sjell nga Kurani Famëlartë është ai i natyrës së njeriut, e cila në vetvete është një provë e ekzistencës së Zotit. Ka disa ligësi që natyra e njeriut në asnjë mënyrë nuk i pranon. Për shembull, imoraliteti me nënën, me motrën ose me bijën, kontakti me urinën, me jashtëqitjen dhe me ndyrësi të tjera, me gënjeshtren etj., janë gjëra që u rrinë larg edhe ateistët. Pse duhet të ishte kështu nëse nuk do të kishte një Zot? Nëse Zoti nuk ekziston, përse burrat bëjnë dallimin mes nënave, motrave dhe mes grave të tjera? Përse njerëzit kanë një urrejtje të natyrshme për gënjeshtren? Mbi çfarë kriteri gjërat e lartpërmendura

janë cilësuar si ligësi te njerëzimi? Nëse zemra e njeriut nuk është nën ndikimin e një Qenieje më të Lartë, pse do të ruhej nga ato? Për të duhej të ishin njësoj, gënjeshtër dhe e vërtetë, padrejtësia dhe drejtësia, që ai të bënte çfarë të dëshironte. Cili është ai ligj Hyjnor që po sunduaka ndjenjat e njeriut, duke ia marrë zemrën si Fron? Një ateist me fjalë del nga sundimi i Zotit, por nuk del dot nga natyrshmëria që ka krijuar Ai. Pra, edhe ateisti u shmanget ligësive, ose të paktën bën sikur po u shmanget. Kjo pa dyshim përbën një argument kundër tij, se ai fshehtas ka frikë se do të japë llogari përpara një Sundimtari, pavarësisht se me gojë refuzon Sundimin e Tij. Kurani Famëlartë pohon:

لَا أُقْسِمُ بِيَوْمِ الْقِيَامَةِ ۖ وَلَا أُقْسِمُ بِالنَّفْسِ اللَّوَّامَةِ ۖ

Betohem në ditën e kiametit (gjkimit)! Dhe betohem në shpirtin që qorton fort!<sup>6</sup>

Kjo do të thotë se njerëzit e kanë gabim kur mendojnë se nuk ka Zot dhe nuk do të ketë as llogaridhënie. Ne ju sjellim dy dëshmi: Dëshmia e parë është që çdo gjë ka një kohë të gjykimit, kur vendoset për të atëherë e mira shpërblehet me të mirë dhe e keqja me të keqe. Nëse nuk ka Zot, pse realizohet ky shpërblim apo

---

<sup>6</sup> Kurani Famëlartë 75:2-3.

dënim? Ata që mohojnë Ditën e Gjykimit, duhet të vërejnë se gjykimi fillon që nga kjo botë. Për shembull, ata që bëjnë kurvëri dhe shkelin kurorën kanë më shumë mundësi të kenë sëmundje veneriane si sifilizi dhe gonorreja sesa ata që janë të martuar, pavarësisht se që të dy përfshihen në të njëjtin akt.

Dhe dëshmia e dytë është ajo e *shpirtit qortues*. Pra, vetë shpirti i njeriut e qorton për mëkate të tilla, sa që edhe ateisti beson se shkelja e kurorës dhe gënjeshtria janë ligësi dhe se mburrja dhe zilia nuk janë të mira. Por, përse duhet të ndodhte kështu, përderisa ateistët nuk njohin asnjë ligj Hyjnor?! A mos vallë sepse nuk ua pranon zemra?! Vetëm sepse ajo përbrenda është e vetëdijshme se do të dalë përpara Sundimtarit të Lartë që do ta ndëshkojë, pavarësisht se nuk e thotë me gojë. Ky argument përmendet në Kuranin Famëlartë edhe në një ajet tjetër:

فَأَهْمَهَا جُورَهَا وَتَقْوَاهَا ۗ

Ai i shpalli shtrembësitë e tij dhe drejtësitë e tij.<sup>7</sup>

Kjo do të thotë se Zoti i Madhërishëm në shpirtin njerëzor ka shpallur shtrembësitë dhe drejtësitë e tij.

---

<sup>7</sup> Kurani Famëlartë 91:9.



Prandaj, ndjesia e së mirës dhe e së keqes në vetvete është një argument i fuqishëm i ekzistencës së Zotit. Po të mos kishte Zot, nuk do të kishte arsye që njerëzit të dallonin të mirën nga e keqja, përkundrazi, secili do të vepronte sipas instinktit të vet.

## ARGUMENTI I KATËRT

Argumenti i katërt që gjejmë në Kuranin Famëlartë për ekzistencën e Zotit është në këto ajete:

وَأَنَّ إِلَىٰ رَبِّكَ الْمُنْتَهَىٰ ۖ وَأَنَّهُ هُوَ أَضْحَكَ وَأَبْكَىٰ ۖ وَأَنَّهُ هُوَ أَمَاتَ وَأَحْيَا ۖ  
وَأَنَّهُ خَلَقَ الزَّوْجَيْنِ الذَّكَرَ وَالْأُنثَىٰ ۖ مِنْ نُّطْفَةٍ إِذَا تُمْنَىٰ ۖ

Nëpërmjet çdo profeti Ne ju kemi dhënë mesazhin se fundi i çdo gjëje është tek Allahu i Madhërishëm. Qofshin gëzime, qofshin hidhërimë, ju vijnë prej Zotit. Vdekja dhe jeta është po në Dorën e Tij. Ai krijoi edhe mashkullin, edhe femrën, përmes një gjëje shumë të vogël, kur ajo hidhet (në vendin e vet).<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> “Dhe sigurisht, te Zoti yt është fundi. Ai është që bën për të gëzuar dhe bën për të qarë. Ai është që shkakton vdekje dhe ringjall. Dhe Ai është që krijoi çiftin, mashkullin dhe femrën; prej një sperme, kur ajo hidhet.” (Kurani Famëlartë 53:43-47) [Botuesi]

Zoti i Madhërishëm në këto ajete tregon se çdo veprim e ka një shkak dhe është e sigurt që sa herë që ndodh një veprim, ekziston një veprues prapa tij. Nga ky parim nëse studioni universin, patjetër do të kuptoni se gjithçka që gjendet në këtë univers përfundon te Zoti, që është Shkak i të gjitha shkaqeve dhe që çdo gjë komandohet me fuqinë e Tij. Zoti i Madhërishëm i tërhoqi vëmendje njeriut për gjendjen e tij fillestare duke thënë: Krijimi yt është bërë nga një spermë dhe sa më shumë që kthehesh mbrapa, aq më i pavlerë bëhesh, atëherë si mund të jesh krijuesi i vetvetes? Nuk mund të ketë krijim pa krijues dhe qeniet njerëzore nuk janë shkaktarët e ekzistencës së tyre siç është e qartë nga rrugëtimi i zhvillimit të tyre nga një gjendje e ulët në një gjendje më të lartë. Prandaj, kur qeniet njerëzore nuk janë shkak i krijimit të vet në gjendjen e tyre aktuale, si mund të jenë të tillë në gjendjen e tyre të ulët? Kjo tregon se krijuesi i tij është dikush tjetër i cili zotëron fuqi të mëdha dhe krijimtari të pafundme. Pra, sa më shumë që thelloheni në zhvillimin gradual të njeriut dhe të shikoni sesi është krijuar ai, aq më të padukshme bëhen mjetet e krijimit dhe të zhvillimit të tij, deri në një pikë ku të gjitha format e njohura të botës nuk ofrojnë shpjegime a njohuri të mëtëjshme për procesin e ekzistencës së njeriut. Pikërisht ajo është

pika ku vepron Dora e Zotit, ku të gjitha shkencat përfundimisht detyrohen të pohojnë se shkaku i kësaj është i pashpjegueshëm dhe i paperceptueshëm për mendjen njerëzore. Kështu, çdo shkencëtar në fund pohon pikërisht atë që thotë Kurani:

وَأَنَّ إِلَىٰ رَبِّكَ الْمُنْتَهَىٰ ﴿٩﴾

Pra, fundi i çdo gjëje është te një Qenie, të cilën mendja njerëzore nuk e rrok dot. Pikërisht Ai është Zoti. Ky është një argument i thjeshtë që mund ta kuptojë çdo njeri, qoftë i shkolluar apo i pashkolluar.

Thuhet se kur dikush pyeti një beduin se çfarë argumenti ka ai për ekzistencën e Zotit, ai i qe përgjigjur:

Kur shoh në pyll kakërdhi deveje, kuptoj se aty ka kaluar një deve. Duke parë gjithë këtë univers dhe të gjitha këto krijesa, si nuk mund të kuptoj që kjo e ka një krijues?!<sup>9</sup>

Çfarë përgjigjeje e vërtetë dhe e natyrshme! Nëse njeriu mediton mbi origjinën e krijimit, ai nuk mund

---

الْبَعْرَةُ تَدُلُّ عَلَى الْبَعِيرِ وَالْأَنْثَرُ الْقَدَمَ عَلَى السَّفِيرِ فَالسَّمَاءُ ذَاتُ الْبُرُوجِ وَالْأَرْضُ ذَاتُ فِجَاجٍ

të shmanget nga një Qenie e Lartë që i krijoi të gjitha krijesat.

## ARGUMENTI I PESTË

Edhe pse i ngjashëm me argumentin e mëparshëm, argumenti i pestë që paraqet Kurani Famëlartë për ekzistencën e Zotit është shumë më i fuqishëm sesa i katërti. Ai thotë:

تَبْرَكَ الَّذِي يَبْدِيهِ الْمَلِكُ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ۝ الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ  
لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا ۗ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْعَفُورُ ۝ الَّذِي خَلَقَ سَبْعَ سَمَاوَاتٍ طِبَاقًا  
مَّا تَرَىٰ فِي خَلْقِ الرَّحْمَنِ مِن تَفَوتٍ ۗ فَارْجِعِ الْبَصَرَ هَلْ تَرَىٰ مِن فُطُورٍ ۝ ثُمَّ  
ارْجِعِ الْبَصَرَ كَرَّتَيْنِ يَنقَلِبْ إِلَيْكَ الْبَصَرُ حَاسِمًا ۗ وَهُوَ حَسِيرٌ ۝

Zotëruesi i bekimit është Ai, në dorën e të Cilit është Sundimi dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë që dëshiron. Ai që krijoi vdekjen dhe jetën, që t'ju sprovtojë se cili prej jush është më i miri në vepra. Dhe Ai është Triumfuesi, Falësi. Ai që krijoi shtatë qiej shkallë-shkallë; ti s'mund të shohësh asnjë të metë në krijimin e të Gjithëmëshirshmit. Andaj, vështroje mirë e mirë! A sheh ndonjë të metë? Vështroje edhe një

herë! Shikimi yt i dështuar do të kthehet te ti dhe do të jetë i lodhur.<sup>10</sup>

Disa njerëz thonë se i gjithë ky univers u krijua rastësisht, ku materia rastësisht u bashkua dhe po në këtë mënyrë gjithçka filloi të krijohej. Të tillët përpiqen ta provojnë teorinë e tyre edhe nëpërmjet shkencës duke pohuar se bota mund të krijohet vetvetiu pa pasur nevojë për ndonjë planifikues.

Në ajetet e mësipërme Zoti i Madhërishëm argumenton duke thënë se gjërat që lidhen me rastësi, asnjëherë nuk kanë ndonjë sistem a renditje, përkundrazi, janë të çrregulluara. Piktura krijohet me bashkimin e ngjyrave të ndryshme, por a mund të bëhet ajo nëse thjesht do të hidhni ngjyra në një letër, pa një synim?! Muri ndërtohet me bashkimin e tullave, por a mund të ngrihet ai vetëm me tulla të hedhura grumbull?!

Edhe sikur të besojmë për një çast se disa herë disa gjëra ndodhin edhe rastësisht, prapëseprapë duke parë universin askush nuk mund të thotë se i gjithë ky sistem të mund të jetë krijuar rastësisht. Le të besojmë se Toka u krijua vetvetiu me bashkimin e materies, po

---

<sup>10</sup> Kurani Famëllartë 67:2-5.

ashtu le ta besojmë se edhe njeriu erdhi në jetë krejt rastësisht, por duhet të ndalemi pak për të menduar se si mund të krijohet një sistem kaq i përsosur.

Duke parë një kryevepër, ne njohim krijuesin e saj. Kur shohim një pikturë të mahnitshme, menjëherë na shkon mendja te dora e ndonjë piktori të madh që mund ta ketë bërë atë. Duke lexuar një kryevepër letrare, kuptojmë se duhet ta ketë shkruar ndonjë shkrimtar i njohur. Sa më shumë renditje dhe përsosuri shohim në veprën e tij, aq më shumë mahnitemi nga madhështia e autorit. Atëherë përse të besojmë se një univers kaq i përsosur të jetë krijuar rastësisht dhe vetvetiu?! Mendoni pakëz që njeriu nga njëra anë ka forcën për të përparuar, nga ana tjetër është i pajisur edhe me mendjen për të sendërtuar idetë e tij. Ngaqë njeriut i duhet të punojë e të sigurojë jetesën, Zoti e krijoi me një trup të përshtatshëm që të lëvizë në Tokë dhe të realizojë dëshirat e tij. Pemën që nuk lëviz, e pajisi me rrënjët që të marrë ushqim direkt nga toka. Luanit i caktoi mishin si ushqim dhe i dha kthetrat dhe dhëmbët e përshtatshme për të zënë gjahun e tij. Ndërsa kalin dhe lopën i la të hanë bar, kështu që ua zgjati qafën që ata të kulloten lehtësisht. Devesë i caktoi të jetojë në shkretëtirë duke ngrënë gjethe dhe

gjemba, andaj i dha qafë akoma më të gjatë. E gjithë kjo vallë, a mund të ketë ndodhur rastësisht?! Si mund të ketë zbuluar rastësia se devesë do t'i duhej një qafë e gjatë, luanit një palë kthetra të fuqishme, pemës rrënjët dhe njeriut këmbët?! Si mund të shpjegohet se diçka që ndodh rastësisht, të jetë e sistemuar me kaq përsosmëri?!

Po të vijojmë me të tjerë shembuj, shohim që nga njëra anë njeriut i dha mushkëri dhe nga ana tjetër krijoi ajrin; e bëri të varur me ujin, kështu që sistemi ciklin e ujit përmes diellit dhe reve që ai të gjejë ujë gjatë gjithë kohës; i dha sytë, kështu që i mundësoi edhe dritën e diellit që sytë të arrijnë të shohin; i dha veshët, kështu që krijoi edhe tinguj të bukur që t'i dëgjojë; i dha gojën, kështu që i mundësoi edhe ushqime të shijshme; i dha hundën, dhe i siguroi edhe aroma të këndshme. Pra, nëse rastësia mund të krijonte mushkëritë e njeriut, si mund të sajonte edhe ajrin që i duhej?! Nëse ajo mund të krijonte edhe sytë, kush është ai që lindi një diell miliona kilometra larg, që sytë të kishin mundësinë e të parit?! Nëse rastësia krijoi veshët, kush i krijoi tingujt?! Nëse besojmë për një çast që qentë dhe arinjte polarë kanë lindur vetvetiu, kush u siguroi një gëzof të përshtatshëm që të jetojnë në zona të ftohta?! Vallë, rastësia krijoi mijëra sëmundje, dhe po

ajo paska krijuar edhe ilaçin e tyre?! Vallë, rastësia lindi barin që ju shkakton kruajtje nëse e prekni, dhe po ajo paska krijuar edhe spinaqin që t'ju sjellë shërimin?!

Është e çuditshme “rastësia” e ateistëve! Gjërave të cilat asgjësohen ose vdesin, u paska lënë sistemin e riprodhimit, kurse gjërave të cilat nuk asgjësohen, nuk ua ka lënë këtë sistem! Kështu, nëse njeriu nuk do të vdiste pas një moshe të caktuar, bota do të merrte fund shumë shpejt, për këtë arsye, edhe njeriu vdes. Kurse dielli, hëna, toka as nuk lindin të reja dhe as nuk vdesin.

Po ky sistem tjetër vallë, a ju duket më pak i çuditshëm që toka dhe dielli kanë gravitet, por ata janë mbajtur mjaftueshëm larg që të mos përplasen me njëri-tjetrin?! Të gjitha këto, a nuk tregojnë se ka një Krijues i cili jo vetëm është i ditur, por i Gjithëdijshtëm?! Ligjet e caktuara prej Tij janë të rregulluara deri në përsosmërinë maksimale dhe nuk kanë asnjë përplasje me njëra-tjetrën. Unë, edhe te gishtat e mi shoh një provë të ekzistencës së Zotit. Mua si njeri më dha dije, dhe në vend të gishtave nëse do të më jepte kthetrat e luanit, a mund të shkruaja me to?! Pra, luanit që nuk i dha dijen, i dha kthetrat ndërsa mua që më dha dije, më dha gishtat që të shkruaj me ta.



Shtetet e mëdha punësojnë mijëra shkencëtarë dhe ekspertë që punojnë natë e ditë për të përmirësuar qeverisjen e tyre. Prapëseprapë vërejmë që ata bëjnë gabime që u sjellin dëme kolosale shteteve të tyre dhe nganjëherë deri në shkatërrim. Por nëse qeverisjen e universit po e mban vetëm rastësia, si shpjegohet që mijëra ekspertë mund të gabojnë dhe kjo rastësi nuk gabuaka asnjëherë. E vërteta është që universi e ka një Krijues që është Sundues dhe i Plotfuqishëm, pa të cilin nuk mund të funksiononte gjithë ky sistem. Tani, hidhni vështrimin në çdo kah, sipas asaj që thotë Kurani Famëlartë, shikimi juaj do të kthehet i dështuar dhe i molisur, pa zbuluar asnjë cen në sistemin e universit dhe në çdo gjë të tij, ju do të shihni një renditje të plotë. Të mirët marrin shpërblimet e tyre dhe të ligjtë ndëshkimin e vet. Çdo gjë brenda universit po funksionon sipas detyrës që i është përcaktuar, pa u treguar e ngathtë për asnjë moment. Kjo temë është shumë e gjerë, por po e mbyll këtu. Të mençurve u mjafton vetëm një shenjë për të kuptuar.

## ARGUMENTI I GJASHTË

Kurani Famëlartë thotë se mohuesit dhe kundërshtarët e Zotit të Madhërishëm gjithmonë poshtërohen dhe shkatërrohen dhe kjo në vetvete është një provë se ata janë gënjeshtarë dhe se Zoti gjithmonë besimtarëve të Tij u jep fitore mbi kundërshtarët. Nëse nuk ka Zot, nga vjen kjo ndihmë dhe mbështetje?! Kësisoj, në lidhje me Faraonin e Musait, Kurani pohon:

فَقَالَ أَنَا رَبُّكُمُ الْأَعْلَى ﴿١١﴾ فَأَخَذَهُ اللَّهُ نَكَالَ الْأَخِرَةِ وَالْأُولَى ﴿١٢﴾

(Faraoni) tha: “Jam unë Zoti juaj, më i madhi”.  
Atëherë Allahu e zuri me një ndëshkim të ahiretit dhe të kësaj bote.<sup>11</sup>

Pra, këto ajete tregojnë se kur Hazret Musai<sup>as</sup> i kërkoi Faraonit që t’i nënshtrohej Zotit të Madhërishëm, ai u tregua kryeneç dhe tha: “Cili Zot? Unë jam Zoti!” Atëherë Allahu i Madhërishëm e poshtëroi edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër. Ngjarja e Faraonit është dëshmi se si kundërshtarët e Zotit poshtërohen dhe shkatërrohen.

Përveç kësaj, asnjë ateist në botë nuk arriti të ndërtojë

---

<sup>11</sup> Kurani Famëlartë 79:25-26.

një perandori [ashtu siç duhej]. Nga ana tjetër, ata që krijuan mbretëri të mëdha në botë, që formuan shtete dhe krijuan histori, gjithmonë kanë qenë nga ata që besonin në ekzistencën e Zotit. Poshtërimi dhe dështimi që patën ata për të krijuar një komb duke mohuar Zotin, a nuk ka ndonjë rëndësi, vallë?!

### ARGUMENTI I SHTATË

Argumenti i shtatë për ekzistencën e Allahut të Madhërishtëm është se ata që besojnë në Të, që mbështeten tek Ai dhe që janë të vërtetë në besimin e tyre, gjithnjë korrin sukses. Pavarësisht nga persekutimi i njerëzve, ata nuk i prek fatkeqësia. Çdo komb pati njerëz, të cilët u bënë thirrje popujve të tyre për të besuar në Zot dhe kundërshtimin që ata patën, nuk e pati ndokush tjetër e megjithatë, bota nuk i dëmtoi dot as sa një fije floku. Çfarë rehatie gëzuan ata që e përzunë Ramçandren<sup>12</sup> në drejtim të pyjeve dhe cilin salltanet arriti të ngrinte Ravana<sup>13</sup> duke e luftuar atë?!

---

<sup>12</sup> *Ramajana* është një poezi epike në tekstet e shenjta të fesë hindu që përshkruan luftën midis princit hyjnor Rama dhe mbretit demon Ravana. [Botuesi]

<sup>13</sup> Në *Ramajana*, Ravana rrëmben Sitanë, gruan e Ramës, për t'u hakmarrë ndaj Ramës dhe vëllait të tij. [Botuesi]

A nuk mbeti gjallë emri i Ramës për mijëra vjet?! A nuk përmendet Ravana me poshtërim përgjithmonë?! Po Kauravatë, çfarë fituan duke refuzuar Krishnanë?! A nuk u shkatërruan ata në fushëbetejën e Krukshterës?!<sup>14</sup> Perandori Faraon që i përdorte si skllëvër Bijtë e Izraelit, i detyronte të përgatisnin dhe të mbartnin tulla, dhe që kundërshtoi një njeri të thjeshtë si Musain<sup>as</sup>, por a arriti ta dëmtonte atë ndopak?! Faraoni u fundos, kurse Musai u bë mbret. Gjithçka që i bëri bota Jezusit të gjithë e dimë dhe ne të gjithë e kemi të qartë se çfarë përparimesh gëzoi populli i tij. Armiqtë e tij u shkatërruan, ndërsa shërbëtorët e tij u bënë mbretër kombesh. Edhe Udhëheqësi ynë, Hazret Profeti Muhammed<sup>savs</sup>, shkëlqeu më shumë se kushdo tjetër në botë në misionin e tij për të përhapur emrin e Zotit të Shenjtë. Aq shumë, saqë një shkrimtar evropian thotë se ai që i çmendur (*me'adhallah*) në punën e tij dhe çdo çast përmendte vetëm Zotin. Atë e kundërshtuan shtatë popuj të ndryshëm. Miqtë iu bënë armiq. Sërish, a nuk ishte ai që fitoi thesaret e botës?! Nëse nuk ka

---

<sup>14</sup> *Lufta e Krukshterës*, ndryshe njihet edhe si *Mahabharata*, është një betejë e përshkruar në epikën e madhe sankrite të titulluar “*Mahabharata*”, të Indisë së lashtë. Beteja dinastike vijoi për 18 ditë mes dy grupeve që ishin kushërinj: *Kauravatë* dhe *Pandavatë*, të cilët luftuan për fronin e Hastinapurës. [*Botuesi*]

Zot, vallë, kush i dha gjithë këtë mbështetje! Nëse ishte rastësi e gjithë kjo, duhej të kishte të paktën një rast kur dikush të vinte për të përhapur emrin e Zotit të Vërtetë dhe të largohej i poshtëruar nga kjo botë. Përkundrazi, cilido që u ngrit për ta lartësuar emrin e Zotit, u nderua dhe shkëlqeu. Për këtë arsye Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

وَمَنْ يَتَوَلَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَالَّذِينَ آمَنُوا فَإِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْغَالِبُونَ ﴿١٥﴾

Ai që bën mik Allahun, të dërguarin e Tij si dhe ata që besuan, (ta dijë se) vetëm grupi i Allahut do të triumfojë.<sup>15</sup>

## ARGUMENTI I TETË

Argumenti i tetë që na jep Kurani Famëlartë për ekzistencën e Zotit është që Ai pranon lutjet. Kur dikush bie në hall dhe i lutet Zotit me përgjërim, Ai ia pranon lutjen. Kjo nuk ishte kufizuar me ndonjë kohë të veçantë, madje sot dhe në çdo kohë ka njerëz që e përjetojnë këtë fakt. Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë pohon:

---

<sup>15</sup> Kurani Famëlartë 5:57.

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ فَلْيَسْتَجِيبُوا لِي  
وَلْيُؤْمِنُوا بِي لَعَلَّهُمْ يَرْشُدُونَ ﴿١٦﴾

Kur robërit e Mi të pyesin rreth Meje, Unë pa dyshim jam afër. I përgjigjem lutjes së lutësit, kur ai Më lutet. Prandaj, edhe ata le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, që të udhëzohen.<sup>16</sup>

Dikush mund të thotë:

Si mund të di se Zoti e dëgjon lutjen? Pse të mos mendoj se disa punë lutësit i realizohen rastësisht, siç disa edhe nuk i realizohen. Nëse të gjitha lutjet e tij pranohen, vetëm atëherë mund të ishte e besueshme kjo gjë.

Përgjigjja e kësaj pyetjeje është që pranimi i lutjes sjell një shenjë me vete. Udhëheqësi ynë, Hazret Mirza Ghulam Ahmed Kadijani, Mesih i Premtuar, Imam Mehdi<sup>as</sup>, ndër të tjera propozoi një provë për ekzistencën e Zotit, duke sfiduar kundërshtarët e tij. Ai sugjeroi të zgjidheshin disa pacientë me sëmundje të rënda dhe

---

<sup>16</sup> Kurani Famëlartë 2:187.

të ndaheshin në dy grupe. Njëri grup të trajtohej dhe të mjekohej nga doktorët, kurse për grupin tjetër ai do t'i lutej Zotit dhe do të shikonin se cilët pacientë do të kishin përmirësimin më të mirë. Çfarë dyshimi mund të kishte në një test të tillë?! Madje, njëherë ngjau që një qen i tërbuar kishte ngrënë një djalë, i cili më pas, pati shenja çmendurie. Mjekët e qytetit Kasuli<sup>17</sup> pohuan me dokument se djali nuk mund të shërohej. Megjithatë, Hazret Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> u lut për të dhe ai u shërua, edhe pse ai që kafshohet nga një qen i tërbuar dhe që ka filluar të shfaqë shenjat e çmendurisë, nuk shërohet. Pra, pranimi i lutjeve është argument se ekziston një Zot që i pranon ato. Pranimi i lutjes nuk është i kufizuar në një epokë të caktuar, por në çdo kohë mund të gjesh shembuj të pranimit. Lutjet siç pranoheshin në të kaluarën, pranohen edhe sot e kësaj dite.

---

<sup>17</sup> Kasuli është një qytet malor në Himaçal Pradesh, në shtetin verior të Indisë. [*Botuesi*]

## ARGUMENTI I NËNTË

Argumenti i nëntë për ekzistencën e Zotit që tregon Kurani Famëlartë është shpallja (*vahji* dhe *ilhami*). Këtë argument po e paraqes të nëntin, por realisht ky është një prej argumenteve më të fuqishme për çështjen në fjalë. Prandaj Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

يُثَبِّتُ اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا بِالْقَوْلِ الثَّابِتِ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الآخِرَةِ

Allahu u jep qëndrueshmëri atyre që besuan përmes fjalës së qëndrueshme në jetën e kësaj bote dhe në ahiret.<sup>18</sup>

Pra, Zoti i Madhërishëm përderisa në çdo kohë komunikon me robërit e Tij, si mund të mohohet ekzistenca e Tij?! Ai komunikon jo vetëm me profetët dhe të dërguarit e Tij, por edhe me njerëzit e tjerë të Tij të dashur (evlijatë). Disa herë mëshiron edhe ndonjë rob të Tij të thjeshtë dhe i drejtohet edhe atij për ta qetësuar. Kështu, edhe me mua Ai ka komunikuar duke e provuar me argumente të fuqishme Qenien e Tij.

---

<sup>18</sup> Kurani Famëlartë 14:28.



Madje, nganjëherë Ai komunikon edhe me njerëzit më të papastër dhe më të ligj për të vulosur mbi ta argumentin përfundimtar të vërtetësisë së Tij. Kështu që, nganjëherë, edhe njerëzit e ulët dhe të mbrapshtë të shoqërisë përjetojnë ëndrra dhe zbulesa, origjina hyjnore e të cilave mund të njihet nga fakti se ato shoqërohen me lajme për të fshehtën që përmbushen në kohën e caktuar, duke treguar qartë se ato nuk buronin nga procese mendore apo nga dispepsia.

Njerëzve të Tij të zgjedhur, disa herë Zoti u tregon ngjarje që do të ndodhin shekuj më vonë, që të mos thotë njeri se rastësisht pa në ëndërr ngjarjet e kohës duke u ndikuar nga situata. Kështu që, Tevratit dhe Kurani Famëlartë në kohën e tyre parashikuan shprehimisht dhe me detaje përparimin e jashtëzakonshëm të popullit të krishterë, fakt për të cilin sot e gjithë bota është e habitur. Madje, Kurani Famëlartë e parashikoi duke numëruar një nga një ngjarjet që do të ndodhnin. Për shembull, në një ajet thotë:

وَإِذَا الْعِشْرَاءُ عُطِّلَتْ ﴿٥٠﴾

Dhe kur devetë me barrë dhjetë muajsh, do të braktisen.<sup>19</sup>

---

<sup>19</sup> Kurani Famëlartë 81:5.

Profeti Muhammed<sup>savs</sup> e shpjegoi këtë ajet në një hadith që gjendet në Sahihun e Imam Muslimit, ku thotë:

وَلْتُرْكَنَ الْقِلَاصُ فَلَا يُسْعَى عَلَيْهَا

Devetë do të dalin jashtë përdorimit dhe askush nuk do të hipë mbi to.<sup>20</sup>

Në kohën e sotme kjo profeci është përmbushur me shpikjen e transportit hekurudhor. Thëniet e tjera të Profetit Muhammed<sup>savs</sup> ju tregojnë thujtë pamje të plotë të trenave, saqë bindeni se fjala profetike e parashikoi një metodë të re të transportit me avull, duke lënë pas një mal me tym, do të mbartte si një gomar barrë të rënda mbi vete dhe do të krijonte zhurmë gjatë lëvizjes, etj..

E dyta:

وَإِذَا الْأَصْحَافُ نُشِرَتْ

Kur librat do të publikohen dhe do të shpërndahen.<sup>21</sup>

Masiviteti në publikimin dhe përhapjen e librave që shohim sot për shkak të shpikjes së shtypshkronjave, nuk do shpjegim.

<sup>20</sup> Sahih Muslim, f. 78, Riyadh, 2000, nr. i hadithit 243. [Botuesi]

<sup>21</sup> Kurani Famëlartë 81:11.

E treta:

وَإِذَا النُّفُوسُ زُوِّجَتْ ﴿٢٢﴾

Kur njerëzit do të bashkohen.<sup>22</sup>

Marrëdhëniet njerëzore dhe lehtësia e komunikimit janë më të dukshme në këtë epokë sesa në çdo kohë tjetër të mëparshme.

E katërta:

يَوْمَ تَرُجُّفُ الرَّاحِفَةُ ﴿٢٣﴾ تَتَّبِعُهَا الرَّادِفَةُ ﴿٢٤﴾

Ky ajet<sup>23</sup> tregon se tërmete të fuqishme do ta dredhin tokën vazhdimisht, profeci e cila gjithashtu u përmbush dhe vijon të përmbushet në këtë kohë.

E pesta:

وَإِنَّ مِنْ قَرْيَةٍ إِلَّا نَحْنُ مُهْلِكُوهَا قَبْلَ يَوْمِ الْقِيَامَةِ أَوْ مُعَذِّبُوهَا

Nuk ka vendbanim që përpara ditës së kiametit Ne të mos e shkatërrojmë atë ose të mos e ndëshkojmë me një ndëshkim të rëndë.<sup>24</sup>

<sup>22</sup> Kurani Famëlartë 81:8.

<sup>23</sup> “Ditën kur do të dridhet dridhësja (toka), të cilën do ta pasojë (dridhja) e dytë.” (Kurani Famëlartë 79:7-8). [Botuesi]

<sup>24</sup> Kurani Famëlartë 17:59.

Në përputhje me këtë, njerëz të panumërt po vdesin nga murtaja, tërmete, furtuna, vullkane dhe luftëra të përgjakshme. Shkaqet e vdekjes së njerëzve që janë shtuar në këtë kohë, nuk mund t'u gjeni shembuj në të kaluarën.

Islami është feja që në çdo shekull solli njerëz, të cilët patën bekimin e komunikimit me Zotin dhe shfaqën shenja të jashtëzakonshme, që patjetër tregojnë ekzistencën e një Zoti të Plotfuqishëm dhe Planifikues. Kështu që, edhe Imamit të kësaj kohe, ndërsa ai po jetonte në një fshat të largët, pa asnjë ndjekës, Zoti i Madhërisëm i dërgoi shpallje duke premtuar:

يَأْتِيكَ مِنْ كُلِّ فَجٍّ عَمِيقٍ - يُنصِّرُكَ رَجَالٌ تُؤْتِيهِمُ مِنَ السَّمَاءِ - وَلَا تُصَعِّرُ لِخَلْقِ اللَّهِ وَلَا تَسْتَمُّ مِنَ النَّاسِ -

Njerëzit do të të vijnë nga çdo rrugë e thellë (dhe) e largët. Burra të cilëve Ne do t'u shpallim prej qiellit do të të ndihmojnë. Mos u trego i ashpër ndaj atyre që do të të vizitojnë ty dhe nuk duhet të lodhesh nga numri i madh i njerëzve.<sup>25</sup>

Një njeri që jetonte në një fshat të largët, të cilin nuk e njihnte askush nga bota e zhvilluar, bën një deklaratë të tillë. Më pas, pavarësisht nga kundërshtimi i ashpër

<sup>25</sup> "Berahin-e-Ahmedia" pj. III, "Rubani Khazain" vëll. 1, f. 267. [Botuesi]

dhe nga pengesat e pakapërcyeshme, bota dëshmon që atij i vijnë njerëz nga Amerika, Afrika dhe nga çdo vend tjetër i botës. Numri i vizitorëve shtohet kaq shumë sa që një njeri i zakonshëm as nuk mund të ketë fuqi për t'i përshëndetur dhe për t'i takuar të gjithë ata. Më pas, një grup i konsiderueshëm njerëzish me ndikim shpërngulen nga vatanet e tyre për t'u vendosur pikërisht këtu dhe kështu ky vend që quhet Kadijan shquhet në të gjithë botën. Vallë, a është e vogël dhe e papërfillshme kjo shenjë?!

Në shembullin e dytë mund të paraqesim atë që ndodhi me një të krishterë nga Amerika e që quhej Duvi [Alexander Dowie], i cili deklaroi të ishte profet dhe botoi këtë deklaratë të pahijshme:

I lutem Zotit që Islami të zhduket nga faqja e dheut sa më shpejt. O Zot! Pranoma lutjen! O Zot! Shkatërroje Islamin!<sup>26</sup>

Atëherë ishte vetëm Udhëheqësi dhe Imami ynë, Hazret Mesihu i Premtuar<sup>as</sup>, ai që u ballafaqua me të dhe botoi një njoftim duke i thënë:

---

<sup>26</sup> "Leaves of Healing", 19 dhjetor 1903. [Botuesi]

O ti që deklaron të jesh profet! Eja dhe bëj *mubahalanë*<sup>27</sup> me mua. Përballja jonë do të jetë përmes lutjes. Ne të dy do t'i lutemi Zotit të Madhërishëm: të vdesë e të shkatërrohet i pari, ai që është gënjeshtar mes ne të dyve!<sup>28</sup>

Por ai u tregua kryeneç dhe tha:

A mendoni se unë do t'u përgjigjem këtyre mushkonjave dhe mizave?... Do t'i mbysja tërësisht po t'i kisha shkel me këmbët e mia.<sup>29</sup>

Por Hazret Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> kishte pohuar dhe po në njoftimin e botuar më 23 gusht 1903 kishte thënë se Dovi edhe sikur të merrte rrugën e arratisë nga sfida, një gjëmë e madhe së shpejti do t'i binte gjithë folesë së tij të Zionit. Hazret Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> u lut:

O Zoti im i Plotfuqishëm! Vendos shpejt dhe tregoju njerëzve gënjeshtrenë e Dovit!

---

<sup>27</sup> *Mubahala* është një lutje duele sipas porosisë së Kuranit: “Ejani të thërrasim bijtë tanë e bijtë tuaj, gratë tona e gratë tuaja, njerëzit tanë e njerëzit tuaj dhe të lutemi me përgjërime që mallkimi i Allahut të bjerë mbi gënjeshtarët!” (Kurani Famëllartë 3:62). [*Botuesi*]

<sup>28</sup> “*The Telegraph*” 5 korrik 1903. [*Botuesi*]

<sup>29</sup> “*Leaves of Healing*”, dhjetor 1903. [*Botuesi*]

Dhe të nderuar lexuesit e mi, më lejoni t'ju them se çfarë ndodhi më pas. Njeriu që jetoi jetën si një princ dhe që zotëronte një pasuri të madhe të kushtuar prej 70 milionë monedha të kohës, iu bënë armiq gruaja dhe i biri. Babai i tij botoi një njoftim duke deklaruar se i biri ishte një fëmijë i jashtëligjshëm. Kurse vetë Dovin e zuri paraliza dhe u çmend nga brengat. Përfundimisht, në fund të marsit të vitit 1907, në gjendje tejet të mjerueshme ai vdiq, mu sipas asaj që i kishte shpallur Zoti i Madhërishtëm të zgjedhurit të Tij, dhe pikërisht ashtu siç kishte parashikuar Hazret Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> në njoftimin e tij të botuar më 20 shkurt 1907. Ai shkroi se Zoti i kishte thënë:

Unë do të shfaq një Shenjë të freskët që do të sjellë fitore të madhe. Kjo shenjë do të jetë për të gjithë botën.<sup>30</sup>

Vdekja e Dovit pa dyshim ishte shenjë e ekzistencës së Zotit. Kjo ishte një fitore që i ishte siguruar Hazret Mesihut të Premtuar<sup>as</sup> mbi rendin e vjetër dhe të ri të botës së krishterë.

---

<sup>30</sup> “*Tadhkirah*”, botimi 2009, f. 920. [*Botuesi*]

Në shembullin e tretë le të kalojmë tek arjët, që dominojnë në këtë shtet [Indi] dhe të cilët dikur udhëhiqeshin nga Lekh Ram. Në libërthin e tij të titulluar “*Kerāmātus-Sādikīn*” të botuar në muajin *safer* të vitit 1311 *hixhri*, Hazret Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> shënoi profecinë e mëposhtme, të cilën, ai thotë se ia dha Zoti i Madhërishëm si shenjë e pranimit të lutjes së tij:

Zoti më ka zbuluar se brenda gjashtë vitesh që nga data e sotme, ky njeri do të bjerë në një ndëshkim të madh për shkak të fyerjeve të tij ndaj Profetit Muhammed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të.

Më pas në një njoftim tjetër të botuar më 22 shkurt 1893, ai parashikoi mënyrën e vdekjes së tij:

عَجَلُ جَسَدِ لَهْ خُوَارِ لَهْ نَصَبُ وَعَدَابُ

Që do të thotë se Lekh Rami është një trup viçi samaritan që pëllet dhe që është i zbrastë nga spiritualiteti, prandaj ai do të ndëshkohet ashtu siç ishte ndëshkuar viçi samaritan.

Të gjithë e dimë se viçi samaritan ishte copëtuar, ishte djegur e më pas ishte hedhur në lumë.



Pas kësaj, më 2 prill 1893, Hazret Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> pa në ëndërr një njeri të fuqishëm dhe të ashpër, sikur të ishte jo njeri, por një engjëll i shkatërrimit dhe që pyet:

“Ku është Lekh Rami?”<sup>31</sup>

Sërish, në vargjet e mëposhtme të librit “*Kerāmātus-Sādikīn*” parashikoi edhe ditën e ndëshkimit të tij:

وَبَشِّرْنِي رَبِّي وَ قَالَ مُبَشِّرًا  
سَتُعْرِفُ يَوْمَ الْعِيدِ وَالْعِيدُ أَقْرَبُ

Ajo do të ndodhë një ditë pas ditës së festës, që do të thotë e shtunë.<sup>32</sup>

Gjithashtu:

الا اء دشمن نادان و بے راه  
بترس از تیغ بران محمدؐ

[O Lekh Ram! Përse shan Profetin Muhammed<sup>savs</sup>? Pse nuk i frikësohesh shpatës së tij që do të të copëtojë ty?]<sup>33</sup>

<sup>31</sup> “*Barakatud-Dua*”, “*Ruhani Khazain*” vëll. 6, f. 33. [Botuesi]

<sup>32</sup> “*Zoti im më dha sibiliqin dhe tha: Do të njohësh ditën e gëzimit, që do të jetë afër ditës së festës.*” (*Tadhkirah*, botimi 2009, f. 314) [Botuesi]

<sup>33</sup> *Tadhkirah*, botimi 2009, f. 293-294. [Botuesi]

Kështu që, pesë vjet përpara ndodhisë, Hazret Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> përshkroi si do të vritej Lekh Rami. Përfundimisht, Lekh Rami u vra më 6 mars të vitit 1897 dhe të gjithë njerëzit njëzëri pohuan se profecia u përmbush në kuptimin e plotë dhe të qartë dhe njëherësh ajo ishte një provë vendimtare për ekzistencën e Zotit.

Shkurt, komunikimi Hyjnor është një argument kaq i pathyeshëm, saqë mohimi i ekzistencës së Zotit edhe pas dëshmimit të kësaj prove, është thjesht mungesë sinqeriteti dhe paturpësi.

## ARGUMENTI I DHJETË

Argumenti i dhjetë për ekzistencën e Zotit është zgjidhje për çdo çështje, të cilin Kurani Famëlartë e jep në këtë ajet:

وَالَّذِينَ جَاهَدُوا فِينَا لَنَهْدِيَنَّهُمْ سُبُلَنَا

Dhe (për) ata që përpiqen në rrugën Tonë, Ne patjetër do t'u tregojmë rrugët Tona.<sup>34</sup>

Të gjithë ata që zbatuan këtë porosi të Kuranit,

---

<sup>34</sup> Kurani Famëlartë 29:70.

gjithmonë kanë përfituar. Mohuesi i Zotit një gjë duhet ta mendojë seriozisht për veten e tij: ai do të jetë në telashe të mëdha, nëse Zoti me të vërtetë ekziston. Duke u nisur nga kjo, nëse ai është i sinqertë për të zbuluar të vërtetën, i duhet që t'i lutet Zotit duke iu përgjyruar dhe duke pasur dëshirë të zjarrtë për t'u lidhur me Të në këtë mënyrë:

O Zot! Nëse Ti ekziston, ashtu siç thonë besimtarët e Tu që Ti zotëron fuqi të pakufishme, më mëshiro, më udhëzo drejt Teje dhe më mbush edhe mua në zemër bindjen dhe besimin ndaj Teje, që të mos ngelem i privuar dhe i humbur!

Ai që bën lutje të tillë me zemër të sinqertë, duke vijuar këtë praktikë të paktën për dyzet ditë, në cilindo komb a besim të ketë lindur, Zoti i botëve patjetër do ta udhëzojë dhe ai shpejt do të shohë se Zoti i Madhërishtëm do të manifestohet përpara Tij duke ia larguar papastërtinë e dyshimit tërësisht. Dihet që kjo mënyrë për të arritur tek e vërteta nuk mund të ketë asnjë lloj mashtrimi. Prandaj, kërkimtarët e së vërtetës çfarë vështirësie mund të kenë për ta ndjekur këtë metodë?!

Edhe pse Kurani Famëlartë ka shumë argumente të tjera për ekzistencën e Zotit, më lejoni të mjaftohem me kaq dhe ta mbyll diskursin tim me këto dhjetë argumente. Nëse dikush thellohet në këto argumente, jam i bindur që po prej tyre atij do t'i dalin shumë të tjera shtesë.

وَاللَّهُ الْمُسْتَعَانُ

*Dhe është Allahu, të cilit i duhet kërkuar ndihmë!*

Në fund, atyre që u bie në dorë ky libërth, do t'u lutesha që pasi ta lexojnë, t'ia kalojnë shokut ose shoqes për të cilin mendojnë se do të jetë i dobishëm.

(Botuar në revistën “*Tesh’hidhul-Edb’han*”,  
mars 1913)

*Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit të Madhërishtëm*

## *Rreth autorit*

I biri i premtuar i Mesihut të Premtuar dhe Imam Mehdiut; shenjë e manifestimit të Allahut të Plotfuqishëm; fjala e Zotit, e cila ishte parashikuar nga Profeti Muhammed<sup>sa</sup> si dhe nga Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> gjithashtu; yll i tillë i qiellit shpirtëror që kërkon qindra vite për t'u shfaqur një herë; njeri i Zotit i kurorëzuar me dritë që rrezaton për të rrënjosur jetën shpirtërore te pasuesit e tij e për të magjepsur ata që nuk kanë pasur fatin e ndjekjes së tij; orator me një kualitet fenomenal saqë fjalimet e tij e mbanin audiencën të vëmendshme për orë të tëra; oqean i dijës shpirtërore; zëri i kohës; gjeni i shekullit XX; njeri me aftësi madhore të lidërsipit e me dhunti të shumta ishte Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed<sup>ra</sup> (1889-1965), i biri i Themeluesit të Xhematit Musliman Ahmedia, Mesihut të Premtuar<sup>as</sup> dhe Kalifi i Dytë i tij. Ai u zgjodh në këtë detyrë që në moshën 24 vjeçare, kur Xhemati ende ishte në periudhën foshnjore. Në një periudhë

mbi pesëdhjetëvjeçare të Kalifatit të tij, ai e rriti, mbrojti dhe e formoi Xhematin përmes udhëzimeve shpirtërore, lutjeve, lotëve, rraskapitjeve dhe gjakut të tij. Ai jo vetëm që forcoi Xhematin, themelet e të cilit ishin hedhur nga Mesihu i Premtuar<sup>as</sup>, por gjithashtu e zgjeroi atë duke inicuar projekte, organizata dhe programe të ndryshme, duke u inspiruar prej Mesihut të Premtuar<sup>as</sup> dhe duke vepruar nën udhëzimin Hyjnor. Ndër prioritetet e tij të para, për të cilin ai e kishte dedikuar veten, ka qenë përmeshja e misionit të Mesihut të Premtuar<sup>as</sup>, misionit madhor të përhapjes së Islamit të vërtetë me vlerat e tij të pacenuara në mbarë botën. Për ta arritur këtë, ai nisi *Tabrik-e-Xhedid*-in, nëpërmjet të cilit dërgoi, dhe vazhdon të dërgohen deri më sot, misionarë të Islamit anembanë botës. Mendjemprehtësia dhe intelekti i tij i lartë, urtësia e tij e madhe dhe, mbi të gjitha, dituria e tij e dhuruar prej Zotit e mundësuan të linte si trashëgimi një korpus të gjerë librash, fjalimesh etj, të cilat do të duan vite për të ardhur në dritë në gjuhë të ndryshme.

Kur Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> bëri lutje të veçanta që Zoti i Madhërishëm t'i dhuronte një djalë për mbështetjen e Islamit, Ai i dha sihariqin e lindjes pikërisht të këtij djali, duke thënë:

“... Unë të jap shenjën e mëshirës në përputhje me atë që më kërkove ... Gëzohu se të jepet një djalë i pashëm dhe i çiltër... Ai do të jetë jashtëzakonisht i zgjuar, mirëkuptues dhe i butë nga zemra. Ai do të begatohet me dituri të dukshme dhe shpirtërore ... Djalë, kënaqësi e zemrës, i lartë e fisnik, manifestim i të Parit e të Fundit, manifestim i së Vërtetës e Triumfit ... Ardhja e tij është shumë e bekuar dhe do të jetë burim i manifestimit të madhësisë hyjnore... ”<sup>1</sup>

---

1 *Mexhmua Ishtiharat* (Përmbledhja e njoftimeve), *Ishtihar* (njoftimi) 20 shkurt 1886, vëll. I, f. 100-103.



# Kontakte

---

**Shqipëri:**

Xhemati Musliman Ahmedia  
Rr. "Pavarësia", KM 1, Mëzez,  
Kutia Postare 8176,  
Tiranë, Shqipëri (Albania)  
Kontakt +355 67 216 8054

[www.alislam.al](http://www.alislam.al)

**Kosovë:**

Xhemati Musliman Ahmedia  
Rr. "Holger Pedersen",  
Lagjja e Spitalit, Prishtinë,  
Kosovë  
+381 3855 8436,  
+377 4481 7813

[www.alislam.al](http://www.alislam.al)

---

**Gjermani:**

Ahmadiyya Muslim Jamaat  
Baitus-Sabuh  
Genfer Str. 11  
60437 Frankfurt am Main,  
Germany  
+49 6950688600

[www.ahmadiyya.de](http://www.ahmadiyya.de)

**Britani e Madhe:**

The Baitul Futuh Mosque  
181 London Rd,  
Morden SM4 5PT, UK  
[www.alislam.org](http://www.alislam.org)

---

**Zvicër:**

Ahmadiyya Muslim Jamaat  
Mahmud Moschee  
Forchstrasse 323  
8008 Zürich  
T +41443815570,  
[www.ahmadiyya.ch](http://www.ahmadiyya.ch)

**Holandë:**

Ahmadiyya Muslim  
Gemeenschap  
Mobarak Moskee,  
Oostduinlaan 79, 2596 JJ Den  
Haag  
T: 070-3245902,  
[www.islamnu.nl](http://www.islamnu.nl)

---

**Spanjë:**

Mezquita Basharat  
14630 Pedro Abad  
Córdoba, Spain  
T +34 957 186203  
[www.alislam.es](http://www.alislam.es)

[www.ahmadiyya-islam.org/es/](http://www.ahmadiyya-islam.org/es/)

**Bosnjë:**

Ahmadija muslimanski džemat  
Tuzlanska 1b, 71000 Sarajevo,  
Bosna i Hercegovina  
Tel/Fax.: 00387-33-612612  
[www.ahmadija.ba](http://www.ahmadija.ba)

---

[www.alislam.al](http://www.alislam.al)



**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Ahmad, Basheer-ud-din Mahmood

Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit / Hazret Mirza  
Bashiruddin Mahmud Ahmed ; përkth. Samad Ahmed  
Ghori ; red. Ina Komino.

– Tiranë : Fondacioni “Xhemati Mysliman Ahmedia i  
Shqipërisë”, 2019

58 f. ; 11 x 17cm.

Tit. origj.: Ten proofs for the existence of God

ISBN 978-9928-4491-2-2

1. Zoti (feja islame) 2. Doktrina fetare 3. Besimi

# Dhjetë argumente për ekzistencën e Zotit

*Ka një debat të ashpër dhe të ndezur mes ateistëve dhe teistëve për ekzistencën e Zotit, gjë që është shenjë e mirë e një fryme intelektuale të shëndetshme e të gjallëruar. Diskutimi mbi ekzistencën e Zotit duhet të fillojë me pranimin se barra e provës qëndron te teistët, domethënë te ata që besojnë në Zot.*

*Në këtë libër Hazret Mirza Bashir-ud-Din Mahmud Ahmed<sup>ra</sup>, Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar, trajton një argument kryesor të ateistëve se nëse Zoti ekziston pse nuk mund ta shohim Atë. Më pas, autori parashtron dhjetë argumente nga Kurani Famëlartë për të treguar me forcë bindëse se ekzistenca e Zotit mund të vërtetohet me siguri të plotë dhe në një mënyrë që nuk mund të hidhet poshtë.*

---

*This is an Albanian translation of the book "Ten Proofs for The Existence of God", written by Hazrat Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmad<sup>ra</sup>, the Second Khalifa of the Promised Messiah<sup>as</sup>.*

[www.alislam.al](http://www.alislam.al)

Çmimi 200 Lekë



XHEMATI MUSLIMAN AHMEDIA  
I SHQIPËRISË

